Të ardhurat vjetore (qarkullim) ≤ € 2 milion Euro ose bilanci i gjendjes * ≤ € 2 milion Euro)

Ndërmarrje të vogla

(Numri i të punësuarve <50 dhe

Të ardhurat vjetore (qarkullim) ≤ € 10 milion Euro ose bilanci i gjendjes * ≤ € 10 milionë Euro)

Kooperativa të cilët janë të themeluara në pajtim me Ligjin për Kooperativa ("Gaz. Zyrtare e RM" nr. 54/02, 84/05) dhe janë të regjistruar në Regjistrin Qendror për kryerje të veprimtarisë bujqësore / përpunim të ushqimit, me seli të regjistruar në mjediset rurale.

(Lista e rrethinave rurale dhe bashkësive rurale në Republikën e Maqedonisë "Gaz. zyrtare e RM" nr. 89/2011 është e shpallur në ueb faqen e Agjencionit www.pa.gov.mk)

Investimet duhet të jenë në përputhje me Listën e pranueshme të aktiviteteve bujqësore alternative të shënuar në Bashkangjitime 5 nga Udhëzuesi për shfrytëzues të mjeteve nga IPARD Programi 2007-2013 për masën 302.

dh) Investime për vendosjen e "Unazave maqinerike"

Organizatat jofitimprurëse të cilët janë të themeluar në pajtim me ligjin për shoqëri tregtare ("Gaz. Zyrtare e RM" nr. 28/04, 84/05, 25/07, 87/08, 42/10, 48/10, 24/11, 166 /12, 70/2013, 119/2013, 120/2013, 187/2013), dhe janë të regjistruar në Regjistrin qendror me jo më shumë se 25% të kapitalit shtetëror





në strukturën pronësore, me seli të regjistruar në mjediset rurale, dhe të njejtit ata duhet të themelohen në baza vullnetare për mbrojtjen e ekonomive bujqësore nga investimet jo-ekonomike që mund të shkaktojnë tepricë të makinerisë dhe pajisjeve bujqësore, si dhe përdorimin racional të makinave bujqësore ekzistuese duke ofruar shërbime për pronarin e makinës dhe të ekonomisë bujqësore e cila nuk ka qëllime specifike bujqësore, me zyrë të regjistruar në mjediset rurale
(Lista e rrethinave rurale dhe bashkësive rurale në Republikën e Maqedonisë “Gaz. zyrtare e RM” nr. 89/2011 është e shpallur në ueb faqen e Agjencionit www.pa.gov.mk)

kooperativa të cilët janë të themeluara në pajtim me Ligjin për Kooperativat (“Gaz. Zyrtare e RM” nr. 54/02, 84/05) dhe janë të regjistruar në Regjistrin Qendror për kryerje të veprimtarisë bujqësore, sigurimin e shërbimeve bujqësore ose prodhimin e inputeve bujqësore, me zyrë të regjistruar në mjediset rurale.

Lista e rrethinave rurale dhe bashkësive rurale në Republikën e Maqedonisë “Gaz. zyrtare e RM” nr. 89/2011 është e shpallur në ueb faqen e Agjencionit www.pa.gov.mk)

e) Investime për vendosjen dhe modernizimin e shërbimeve private veterinarë

Persona juridik – të cilët janë të themeluar në pajtim me ligjin për shoqëri tregtare (“Gaz. Zyrtare e RM” nr. 28/04, 84/05, 25/07, 87/08, 42/10, 48/10, 24/11, 166/12, 70/2013, 119/2013, 120/2013, 187/2013), dhe janë të regjistruar në Regjistrin qendror si tregtar individual apo shoqëri tregtare, me seli të regjistruar në mjediset rurale. Kërkues të pranuar janë ata që nuk kanë më tepër se 25% kapital shtetërorë në strukturën pronësore dhe të njejtët janë në rangun e ndërmarrjeve mikro në përputhshmëri me Rekomandimin 2003/361/EC.

(Lista e rrethinave rurale dhe bashkësive rurale në Republikën e Maqedonisë “Gaz. zyrtare e RM” nr. 89/2011 është e shpallur në ueb faqen e Agjencionit www.pa.gov.mk)

Çfarë është mikro ndërmarrje dhe ndërmarrje e vogël në përputhje me Rekomandimin 2003/361/EC?

Mikro ndërmarrje

(Numri i të punësuarve <10 dhe

Të ardhurat vjetore (qarkullim) ≤ € 2 milion Euro ose bilanci i gjendjes * ≤ € 2 milion Euro)

Ndërmarrje të vogla

(Numri i të punësuarve <50 dhe

Të ardhurat vjetore (qarkullim) ≤ € 10 milion Euro ose bilanci i gjendjes * ≤ € 10 milionë Euro)

f) Investime në turizëm rural:

- **ekonomi bujqësore**- të cilët janë të regjistruar në Regjistrin qendror të ekonomive bujqësore në MBPE në pajtim me Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural (“Gaz. Zyrtare e RM” nr. 134/2007, 49/10, 53/11, 126/12, 15/13, 69/2013, 106/2013),

- Për investimet në turizëm të venës aplikuesit duhet të sigurojnë dëshmi që posedojnë kapacitet minimal vjetor të prodhimit të fidaneve të vreshtave ekvivalent me kapacitetin prodhues për prodhimin e verës prej së paku prej 20hl deri në maksimum 400hl.





- Kapaciteti i propozuar për akomodim të brendshëm të ekonomive bujqësore nuk duhet të jetë më shumë se 10 dhoma (duke përfshirë banesa) për të akomoduar maksimal 30 persona (duke përjashtuar krevate shtesë për fëmijët)
- Kapaciteti i propozuar për shërbime hotelierike / objekte për digustim duhet të jenë të organizuar për ndarje të ushqimit maksimum për 60 mysafirë

- **persona juridik** – të cilët janë të themeluar në pajtim me ligjin për shoqëri tregtare (“Gaz. Zyrtare e RM” nr. 28/04, 84/05, 25/07, 87/08, 42/10, 48/10, 24/11, 166/12, 70/2013, 119/2013, 120/2013, 187/2013), dhe janë të regjistruar në Regjistrin qendror si tregtar individual apo shoqëri tregtare me seli të regjistruar në mjediset rurale ku është i lokuar investimi. Personat juridik duhet të regjistrohen për kryerjen e këtyre veprimtarive të pranuar: turizëm, hotelieri, bujqësi, pylltari dhe gjueti, peshkatari dhe akuakulturë ose prodhim të verës. Kërkesat të pranuar janë ata që nuk kanë më tepër se 25% kapital shtetërorë në strukturën pronësore dhe të njëjtët janë në rangun e ndërmarrjeve mikro në përputhshmëri me Rekomandimin 2003/361/EC.

- Në rast se aplikanti është i angazhuar në prodhimin e verës i njëjti duhet të jetë i regjistruar në Regjistrin për prodhimin e verës - në MBPE;
- Në rast se aplikanti është i angazhuar në peshkim dhe akuakulturë, duhet të jetë i regjistruar në Regjistrin e akuakultures - në MBPE. Kapaciteti i propozuar për akomodim të brendshëm nuk duhet të jetë më shumë se 30 dhoma për të akomoduar maksimal 50 persona (duke përjashtuar krevate shtesë për fëmijët), përkatësisht kapacitetet e propozuara për akomodim të jashtëm nuk duhet të jetë më shumë se 30 njësi akomodimi për maksimum 90 persona;
- Kapaciteti i propozuar për shërbime hotelierike / objekte për digustim duhet të jenë të organizuar për ndarje të ushqimit maksimal për 70 mysafirë;

- **Persona fizik** të regjistruar me vendbanim të përhershëm në një zonë rurale, aty ku gjendet toka / objekti ku planifikohet investimi, dhe e njëjta është në pronësi private nga aplikanti personi fizik.

- Kapaciteti i propozuar për akomodim të brendshëm nuk duhet të jetë më shumë se 10 dhoma për të akomoduar maksimal 20 persona (duke përjashtuar krevate shtesë për fëmijët), përkatësisht kapacitetet e propozuara për akomodim të jashtëm nuk duhet të jetë më shumë se 10 njësi akomodimi për maksimal 30 persona;
- Kapaciteti i propozuar për shërbime hotelierike / objekte për digustim duhet të jenë të organizuar për ndarje të ushqimit me kapacitet maksimal prej 50 mysafirë;
- Kapacitetet për shërbime hotelierike / objekte për digustim duhet të jenë të shoqëruar me objektet për akomodim rural;





- Objektet që janë subjekt i investimeve në fund të zbatimit të investimeve duhet të i plotësojnë standardet për kategorizimin në përputhje me Ligjin për hotelieri (“Gaz. Zyrtare e RM” nr. 62/04, 89/08, 115/10, 53/11, 141/12, 164/2013, 187/2013) si dhe Niveli i komoditetit dhe e cilësisë së shërbimit duhet të përputhen me Tabelat për standardet minimale të cilësisë, që rrjedhin nga ndarja e EUROGITES për akomodim rural - 2005 të përcaktuara në Bashkangjitje 6 nga Udhëzuesi për shfrytëzues të mjeteve nga IPARD Programi 2007-2013).

3) Aplikantët e ekonomive bujqësore përkatësisht personi përgjegjës duhet të tregojë minimum arsim të mesëm ose arsim të lartë të përfunduar.

Aplikantët për investime në turizmin rural, përpunimin e ushqimit dhe të zejtarisë duhet të tregojë shkallë përkatëse të përfundimit të arsimit profesional të tilla si:

- Në pajtim me Rregullat mënyrës për kontrollim të njohurive dhe mënyrës për lëshim të certifikatave për fitimin e njohurive themelore të higjienës ushqimore dhe mbrojtjen e mjedisit (“Gaz. Zyrtare e RM” nr. 118/2005);
- Në pajtim me Ligjin për Arsimin Profesional dhe Trajnim (“Gaz. Zyrtare e RM” nr. 71/2006, 117/2008 dhe 148/09), certifikata mund të merret në institucionet e arsimit dhe formimit profesional (shkollat për arsim profesional dhe qendra për trajnim profesional);
- Në pajtim me Ligjin për Arsimin e Lartë (“Gaz. Zyrtare e RM” nr. 103/08, 26/09, 83/09, 99/09, 115/10, 17/11, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13);

5.2.

Lartësia e finansimit sipas masës 302

Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme është 3 000 euro (185.055,00 në kundërvlerë denarë)

Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme nuk duhet të tejkalojë shumën prej 450.000 euro (27.758.250,00 në kundërvlerë denarë), përkatësisht **shuma maksimale e shpenzimeve të pranueshme mund të rritet për këto lloje të investimeve**

- 550.000 € (33.926.750,00) në kundërvlerë denarë për shfrytëzues për llojin e investimeve 30212 dhe 30241

- 750.000 (46,263.750,00) në kundërvlerë denarë për shfrytëzues për llojin e investimeve 30211, 302 221 dhe 30 231

Shuma e përgjithshme maksimale e shpenzimeve të pranueshme për ko-financim të një shfrytëzuesi nuk mund të tejkalojnë buxhetin e mësipërm financiarë në kuadër të periudhës financuese 2007-2013.

Kërkuesit mund të dorëzojnë projekte në kuadër të kësaj mase në periudhën e implementimit të Programës, me kusht që të mos kalohet vlera maksimale e harxhimeve të pranuar për këtë masë dhe projektet e mëparshme të jenë me sukses të mbaruara, gjegjësisht përkrahja financiare të jetë plotësisht e paguar.





6.	Shpenzimet e pranueshme të përgjithshme
	<p>Shpenzimet e pranueshme për ko-financim kanë të bëjnë me:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) ndërtim ose rindërtim të objekteve b) furnizim të mbjelljeve shumëvjeçare c) furnizim të makinave dhe pajisjeve të reja, duke i inkuadruar softuerët kompjuterik në shumë të vlerës së tregut të mjeteve ç) shpenzime të përgjithshme të lidhura me shpenzime të pranueshme të dhëna në pikat a), b), dhe c) siç janë arkitektë, inxhinierë dhe shpenzime të tjera konsultative, fizibiliteti studime, fitimin e të drejtave të patentëve dhe licencave në shumë maksimale prej 12% nga shpenzimet e pranueshme të përgjithshme të dhëna në pikat a), b), dhe c) dhe janë në pajtueshmëri me kushtet në vijim: <ul style="list-style-type: none"> - për projektet me gjithsej shpenzime të pranueshme të investimeve të dhëna në pikat a), b) dhe c) më të vogla se 1.000.000,00 euro ose në kundërvlerë prej 61.685.500,00 denarëve dhe 3.000.000,00 euro ose në kundërvlerë prej 185.055.000,00 denarëve, shpenzimet për përpunimin e përpilimin e planit të punës nuk mund të jenë më të mëdha se 4% nga shpenzimet e arsyeshme të këtyre investimeve, dhe <p><u>Shpenzimet e pranueshme specifike sipas llojeve të investimeve janë të dhëna detajisht për secilën masë posaçërisht dhe lloj të investimit në Udhëzimin për përdoruesit e mjeteve sipas IPARD Programit 2007-2013.</u></p> <p>Shpenzimet e pranueshme të kofinancimit duhet të jenë nga vendet anëtare të Bashkësisë Evropiane, vendet kandidatë për anëtarësim në Bashkësinë Evropiane, vendet kandidat potencial për anëtarësim në Bashkësinë Evropiane dhe vendet shfrytëzues të instrumentit “Fqinjësi dhe partneritet evropian” dhe vende të tjera të cilat kanë qasje reciproke në ndihmën e jashtme të Bashkësisë Evropiane. Lista e këtyre vendeve është e dhënë në <i>Udhëzimin për shfrytëzuesit të mjeteve sipas IPARD Programit 2007-2013</i></p>
7.	Shpenzimet e papranueshme
	<p>Shpenzimet në vijim nuk janë të pranueshme për ko-financim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - tatime, duke inkuadruar edhe tatimin e vlerës së shtuar; - tatime doganore dhe tatime tjera importi, ose tatime tjera; - blerje, huamarrje ose qira të tokës dhe objekteve ekzistuese, pavarësisht nga ajo nëse qiraja do të sjellë deri te transferimi i pronësisë së qiramarrësit; - dënime, dënime financiare dhe shpenzime nga kontestet gjyqësore; - shpenzime operative; - pajisje dhe makina të përdorura; - tatime bankare, shpenzime për garanci dhe tatime të ngjashme; - shpenzime për konvertim (kthim), të dhëna dhe humbje nga kursi devizor të lidhur me llogarinë në euro të IPARD, si dhe vetëm shpenzime tjera financiare;





	<ul style="list-style-type: none"> - kontribute në natyrë; - blerje të të drejtave për prodhime bujqësore, blegtori, bimë vjetore dhe kultivimin e tyre; - çfarëdo mirëmbajtje, amortizim dhe shpenzime për qira; - shpenzime të administratës publike në udhëheqjen dhe zbatimin e ndihmës, pikërisht të atyre në strukturën operative dhe, posaçërisht shpenzimet e regjisë, qiratë dhe rrogat e personelit të angazhuar për aktivitete të udhëheqjes, aplikimit, përcjelljes së kontrollit.
8.	Llogaritja e kursit të euros
	<p>Shumat e shprehura në euro llogariten në kundërvlerë denarë sipas kursit të mesëm të euros të vërtetuar nga Banka qendrore evropiane.</p> <p>Për muajin shkurt 2013, kursi i euros është 61,685000 denarë për 1 euro (www.ec.europa.eu/budget/infocuro).</p>
9.	Afati për realizimin e investimit
	<p>Periudha e pranueshme për realizimin e secilit investim është më së shumti 24 muaj nga dita e nënshkrimit të Marrëveshjes për përdorim të mjeteve.</p>
10.	Kriteret dhe kushtet e përgjithshme për shfrytëzim
	<p>Kërkuesi duhet të mbushë dhe dorëzojë Kërkesë për shfrytëzim të mjeteve sipas masës përkatëse si dhe:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Plan afarist ose Projekt propozues teknik, me të cilin tregohet qëndrueshmëria/llogaria ekonomike dhe mundësia për punësime të reja i cili përpilohet në pajtim me <i>Udhëzimin për përpilimin e planit afarist</i>; <p>Dokumentacion për procedurë të kryer për mbledhjen e të paktën tre ofertave nga ofrues të ndryshëm të pavarur me specifikimet teknike dhe vendin e prejardhjes për secilin furnizim, mall dhe shërbim veç e veç, si dhe deklarata nga ana e prodhuesit/furnizuesit për vendin e prejardhjes së prodhimeve të ofruara, përderisa vlera e përcaktimit individual paraqet shumën më tepër se 10.000 euro, ose në kundërvlerë prej 616.850,00 denarë, gjegjësisht një ofertë nga një ofrues i pavarur me specifikimet teknike dhe vend të prejardhjes për secilin furnizim individual të mallrave dhe shërbimeve si dhe deklarata të prodhuesit/furnizuesit për vendin e prejardhjes së prodhimeve të ofruara, përderisa vlera është nën 10.000 euro ose në kundërvlerë prej 616.850,00 denarë. Ofertat duhet të merren nga persona me të cilët kërkuesi nuk ka lidhje pronësore, farefisnore dhe/ose nga furnizuesit të cilët nuk janë ndërmjet veti në lidhje pronësore apo familjare, e as në të cilët paraqiten persona të njëjtë në pjesën e strukturës udhëheqëse.</p> <ol style="list-style-type: none"> 2. ti ketë shlyer e detyrimet në bazë të tatimeve dhe kontributeve ndaj shtetit në bazë të sigurimit shëndetësor, pensional dhe social. Agjencioni do të kontrollojë përmbushjen e këtij kriteriumi në bazë të vërtetimit për tatime dhe detyrime të paguara të cilën do ta mer nëpërmjet detyrës zyrtare nga Drejtoria e të hyrave publike. 3. dëshmi për pagimin e detyrimeve ndaj Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave në bazë të marrëveshjes, 4. dëshmi se është pronar i tokës bujqësore ose ka marrëveshje për qira ose të drejtë për shfrytëzim të tokës bujqësore për më së paku 5 vjet gjegjësisht 10 vjet në rast kur investimet





kanë të bëjnë me përtëritjen e të mbjellave shumëvjeçare ose përmirësimin e sistemit të ujitjes.

5. dëshmi se është pronar i objektit ndërtimorë ose ka marrëveshje për qira ose të drejtë shfrytëzimi të objektit ndërtimorë për më së paku 5 vjet gjegjësisht 10 vjet në rast kur investimet kanë të bëjnë edhe me punët ndërtimore. Në rast të ndërtimit të një objekti të ri, duhet të dorëzohet dëshmi për pronësi të tokës për ndërtim ose të drejtë për shfrytëzimin e tokës ndërtimore.
6. të përgatit dhe dorëzojë dokumentacion projektues të reviduar së bashku me planet për ndërtim/rindërtim në qoftë se investimi përfshin edhe punët ndërtimore, dhe dëshmi që projekti i plotëson standardet ndërtimore të Komunës dhe standardet tjera në pajtim me planet urbanistike ose hapësinore
7. dëshmi për shpenzimet e përgjithshme të bëra dhe shpenzimet për përpilimin e planit afarist të bëra pas 01.01.2007,
8. dëshmi për pajtueshmëri të investimit me Strategjinë për zhvillim lokal të komunës në të cilën gjendet investimi. Përderisa komuna ende nuk e ka aprovuar Strategjinë për zhvillim lokal në kohën e dorëzimit të kërkesës për shfrytëzimin e mjeteve, kërkuesi në planin afarist bashkëngjit analizën e kontributit të investimit për zhvillimin ekonomik lokal në komunën në të cilën gjendet investimi dhe
9. mendim nga trup profesional përkatës për përmbushjen e ligjeve relevante nacionale dhe standardeve relevante të Unionit Europian në lidhje me investimet.

Investimet duhet ti plotësojnë standardet minimale nacionale për mbrojtje të ambientit jetësor, shëndetësisë publike, shëndetin e kafshëve dhe bimëve, begatinë e kafshëve dhe mbrojtja gjatë punës deri në momentin kur të silllet vendim për aprovim të përkrahjes financiare .

Në rast kur standardet nacionale minimale të cilat janë në pajtim me standardet e Bashkimit Evropian, janë zbatime të reja në periudhën kur kërkesa për përkrahje financiare është dorëzuar, përkrahja mund të ndahet pa dallim të papërshtatshmërisë me standardet por me kusht që zbatimet e reja të standardeve të arrihen me realizimin e investimit.

Dokumentet të cilat jepen në bazë të librave publik ose sistemit itë themeluar të evidentimit nuk duhet të jenë më të vjetër se tre muaj nga dita e publikimit të shpalljen publike.

Në pajtueshmëri me Rregullimin për mënyrën dhe procesin e përdorimit të përkrahjes financiare për masat e zhvillimit rural të financuara nga ana e Komponentit V – IPARD nga instrumenti për ndihmë para anëtarësimit IPA (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 112/09) dokumentet të cilat dorëzohen në mbështetje të kërkesës për përdorimin e mjeteve duhet të jenë në origjinal në gjuhën maqedonase ose kopje të vulosur në noter, nëse nuk është e përcaktuar ndryshe. Nëse dokumentacioni është në gjuhë tjetër e njëjta duhet të jetë e shoqëruar me përkthim në gjuhën maqedonase e vulosur nga përkthyes zyrtar, mirëpo nëse bëhet fjalë për dokument zyrtar të një shteti tjetër atëherë duhet të jetë e verifikuar me apostil

Informata më të detajuara për kërkesa specifike për pranueshmëri janë të shprehura në *Udhëzimit për shfrytëzuesit e mjeteve sipas IPARD Programit 2007-2013.*





11.	Procedura para Agjencisë
	<p>1. Procedura e Agjencisë prej pranimit të Kërkesave deri në realizimin e marrëveshjes për shfrytëzimin e mjeteve përbëhet nga:</p> <p>1. Kontroll të kompletimit të dokumenteve të dorëzuara në pajtueshmëri me dokumentet e kërkuara sipas masave dhe llojeve të investimeve dhe atë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nëse dokumentet janë të dhëna nga institucionet përkatëse; • Nëse dokumentet i posedojnë të gjitha elementet me të cilat dëshmojnë se janë të besueshme (vulë, nënshkrim të personit përgjegjës, datë etj.) • Nëse dokumentet janë me afat të vazhdimin i cili është i cekur në <i>Kërkesën për shfrytëzimin e mjeteve</i>; <p>Kërkuesi duhet të kryejë plotësim të kërkesave të paplotësuara për shfrytëzimin e mjeteve në bazë të lajmërimit të fituar me shkrim nga ana e Agjencisë. Afati për plotësimin e kërkesave të paplotësuara nuk mund të jetë më i shkurt se 8 ditë.</p> <p>2. Kontroll të përshtatshmërisë së kërkesës për shfrytëzim të mjeteve bëhet me qëllim që të vërtetohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nëse dokumentet e dorëzuara argumentojnë plotësim të kriterëve dhe kushteve për pranueshmëri të aktiviteteve të propozuara investuese; • Nëse investimi i propozuar është ekonomikisht dhe financiarisht i realizueshëm dhe i përmbajtur, i cili kontrollohet përmes analizës së parametrave të përmbajtur në planin e bashkëngjitur afarist; • Nëse investimi i propozuar për të cilin kërkohet përkrahje financiare nuk është i financuar nga burime të tjera publike të mjeteve (Buxheti i Republikës së Maqedonisë dhe donatorët ndërkombëtar); • Nëse çmimet e aktiviteteve të propozuara investuese janë në kuadër të çmimeve të tregut përmes analizës së çmimeve referente për aktivitete përkatëse. <p>Me qëllim të vërtetimit të autenticitetit të parametrave teknik, të dhënave ekonomike dhe financiare, Agjencioni ka të drejtë të kërkojë dokumente dhe informata shtesë si bazë për sjelljen e vendimit.</p> <p>Verifikimin e besueshmërisë së të dhënave në Kërkesën për shfrytëzim të mjeteve e kryejnë persona të autorizuar të Agjencisë me kontrollim në vendin e ngjarjes.</p> <p>Rangimi u bëhet të gjitha kërkesave të kompletuara dhe të përshtatshme për shfrytëzimin e mjeteve në pajtueshmëri me tabelat e paraqitura për rangim sipas masave të veçuara.</p> <p>Përkrahja financiare do të aprovohet për të gjitha kërkesat e kompletuara dhe të përshtatshme për shfrytëzimin e mjeteve në kuadër të mjeteve në dispozicion sipas masës në bazë të kontrollimit administrativ të bërë në vend të ngjarjes.</p> <p>Kërkesat e pakompletuara dhe jo përkatës, si dhe kërkesa për shfrytëzimin e mjeteve të cilët kanë numër më të vogël të pikëve në lidhje me mjetet në dispozicion sipas masës, do të jenë të refuzuara</p>





	<p>me Vendim.</p> <p>Me kërkuesin, kërkesa e të cilit për shfrytëzim të mjeteve është e miratuar, nënshkruhet Marrëveshje në afat prej 30 ditëve nga dita e marrjes së Vendimit për aprovim të mjeteve nga IPARD Programi.</p> <p>Kërkuesit nuk guxojnë të fillojnë me realizimin e investimeve para nënshkrimit të Marrëveshjes për shfrytëzim të mjeteve me Agjencinë, në përjashtim të aktiviteteve të lidhura me shpenzimet e përgjithshme (përpilimin e planit afarist, fizibili studimit (studimit të realizueshmërisë), arkitektët, dokumentacioni për projekte).</p> <p>Pas mbarimit të investimit, kërkuesi është i detyruar të dorëzojë në Agjenci kërkesë për pagesë në afatin e vërtetuar në Marrëveshje për shfrytëzimin e mjeteve.</p> <p>Kërkuesi i cili do të nënshkruajë marrëveshje me Agjencinë është i obliguar që investimin që është lëndë e marrëveshjes mos ta huazojë, mos ta japë me qira, mos t'ia ndërrojë synimin dhe lokacionin e të njëjtës gjatë tërë kohës së marrëveshjes gjegjësisht 5 vjet nga pagesa e fundit të mjeteve financiare.</p> <p>Kontrollim në vend të ngjarjes dhe aplikim të mbikëqyrjes ndaj marrëveshjes bëjnë persona të autorizuar nga institucionet relevante të Republikës së Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian.</p> <p>Në pajtim me Ligjin për themelimin e Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural,(Gaz. Zyrtare e RM” nr. 72/07, 5/09), Agjencioni vendos në lidhje me kërkesën e dorëzuar për shfrytëzimin e mjeteve gjegjësisht kërkesë për pagim më së voni në afat prej tre muajve nga dita e mbarimit të afatit për dorëzim të kërkesës për përdorim të mjeteve, gjegjësisht të Thirrjes publike për dorëzim të kërkesave për shfrytëzim të mjeteve dhe tre muaj nga dita e pranimit të kërkesës për pagim.</p> <p>Kërkesat për shfrytëzim të mjeteve, si dhe dokumentet e bashkëngjitura nuk kthehen.</p>										
12.	Kriteret për zgjedhje të përdoruesve										
12.1.	<p>Kriteret për rangim të kërkesave sipas masës 101</p> <p>Kërkesat të cilat i plotësojnë kushtet për shfrytëzimin e përkrahjes financiare për masën 101 rangohen me pika në këtë mënyrë:</p> <table border="1" data-bbox="332 1459 1421 1774"> <thead> <tr> <th data-bbox="332 1459 418 1575"></th> <th data-bbox="418 1459 673 1575">Qëllimet e masës</th> <th data-bbox="673 1459 1096 1575">TREGUES</th> <th data-bbox="1096 1459 1299 1575">Pikat në rast të përmbushjes</th> <th data-bbox="1299 1459 1421 1575">Maks.</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="332 1575 418 1774">1</td> <td data-bbox="418 1575 673 1774">Përkrahje e shoqatave të zejtarëve dhe aktiviteteve zejtare</td> <td data-bbox="673 1575 1096 1774">Përderisa investimi është propozuar nga ana e bujqve individual, të cilët janë anëtarë të kooperativës bujqësore ose shoqatave të bujqve</td> <td data-bbox="1096 1575 1299 1774">35</td> <td data-bbox="1299 1575 1421 1774">35</td> </tr> </tbody> </table>		Qëllimet e masës	TREGUES	Pikat në rast të përmbushjes	Maks.	1	Përkrahje e shoqatave të zejtarëve dhe aktiviteteve zejtare	Përderisa investimi është propozuar nga ana e bujqve individual, të cilët janë anëtarë të kooperativës bujqësore ose shoqatave të bujqve	35	35
	Qëllimet e masës	TREGUES	Pikat në rast të përmbushjes	Maks.							
1	Përkrahje e shoqatave të zejtarëve dhe aktiviteteve zejtare	Përderisa investimi është propozuar nga ana e bujqve individual, të cilët janë anëtarë të kooperativës bujqësore ose shoqatave të bujqve	35	35							





			Përderisa investimi është e propozuar nga kooperativa bujqësore	30	
			Përderisa investimi është e propozuar nga persona juridik të përcaktuar nga shoqatat e bujqve	25	
	2	Përparimi i mbrojtjes së rrethinës	Përderisa investimi është i orientuar drejt vendosjes së sistemit për kursim të energjisë dhe kursimit të ujit në ekonominë bujqësore, si dhe përparim të praktikave bujqësore për mbrojtje të ambientit jetësor	25	25
	3	Përmirësim të strukturës gjimore dhe moshës në hapësirat rurale	Përderisa bartës të ekonomisë bujqësore për të cilën është e dhënë investimi është grua	15	30
			Përderisa investimi është i propozuar nga ana e bujqve të rinj (mes moshës 18 dhe 40)	15	
	4	Orientimi tregtar i prodhimit bujqësor	Përderisa dorëzimi i prodhimit primar të prodhuar në ekonominë bujqësore në rrjetin e tregut për ushqim është në bazë të rrugës së marrëdhënieve të marrëveshjes	10	10
				GJITHSEJ	100
12.2.	Kriteret për rangim të kërkesave sipas masës 103 Kërkesat të cilat i përmbushin kushtet për përdorim të përkrahjes financiare për masën 103 janë të ranguar në këtë mënyrë:				





	Qëllimet e masës	TREGUES	Pikat në rast të përmbushjes	Maks. pikë
1	Qëllimi i projektit	Përderisa investimi është për qëllim të modernizimit dhe përkryerjes teknologjike të ndërmarrjeve ekzistuese gjatë kohës së mbylljes së ndërmarrjeve të vjetra	30	30
		Përderisa investimet kanë për qëllim hapjen e qendrave për blerjen e pemëve dhe perimeve të freskëta ose qumështit të papërpunuar ose thertoreve për kafshë.	25	
		Përderisa investimet kanë për qëllim modernizimin dhe përsosshmërinë teknologjike të ndërmarrjeve ekzistuese me qëllim të rritjes së kualitetit të prodhimit.	20	
2	Mbrojtja e ambientit jetësor	Përderisa investimet kanë për qëllim zvogëlimin e ndikimit negativ ndaj ambientit jetësor përmes pastrimit të ujit	15	30
		Përderisa investimet kanë për qëllim pastrimin e mbeturinave dhe riciklimin në kohën e valorizimit të nus prodhimeve	15	
3	Kontrolli i përmirësuar i kualitetit të prodhimeve	Përderisa investimet kanë për qëllim hapjen e laboratorëve ose modernizim të atyre ekzistues	15	25
		Përderisa investimet kanë për qëllim pajisjet për mbikëqyrje të kualitetit, sistemeve për kontrollim dhe përcjellje	10	
4	Marrëdhënie të kontraktuara me prodhues individual bujqësor	Përderisa investimi ka të bëjë me modernizimin e ndërmarrjeve ekzistuese, ndërsa furnizimet personale dhe marrëdhëniet e kontraktuara me prodhues bujqësor individual përfshijnë më së paku 50% të furnizimeve dhe kanë të bëjnë me periudhën prej më pak se një vjet	15	15





		Përderisa bëhet fjalë për investime të reja, ndërsa furnizimet personale dhe marrëdhëniet kontraktuese me prodhuesit bujqësor individual përfshijnë më së paku 50% të furnizimeve të lëndëve të para për periudhën prej më pak se një vit pas përfundimit të projektit.	10	
			GJITHSEJ	100

Kriteriume për rangimin e kërkesave sipas llojeve të investimit 10343, investime në rikonstruimin e kapaciteteve prodhuese për përpunimi e mishit.

Kërkesat të cilat i përmbushin kushtet për shfrytëzim të përkrahjes financiare për llojin e investimit 10343 rangohen në këtë mënyrë:

	Qëllimet e masës	TREGUES	Pikat në rast të përmbushjes	Maks. pikë
1	Qëllimi i projektit	Përderisa shfrytëzuesi është kompani për përpunimin e mishit	40	40
		Përderisa shfrytëzuesi është thertore	30	
2	Mbrojtje të ambientit jetësor	Përderisa shfrytëzuesi ka lidhje me kanalizimin publik	30	30
		Përderisa shfrytëzuesi përdor gropa për ujëra të zeza si sistem e kanalizimit	20	
3	Ndihmë për gra dhe operatorë të rinj ekonomik	Përderisa personi përgjegjës tek personi juridik është grua	15	30
		Përderisa investimi është propozuar nga operatorë të ri ekonomik (ndërmjet 18 dhe 40 vjet)	15	
			GJITHSEJ	100

12.3. Kriteret për rangim të kërkesave sipas masës 302
Kërkesat të cilat i përmbushin kushtet për shfrytëzim të përkrahjes financiare për masën 302 rangohen me pika në këtë mënyrë:





	Qëllimet e masës	TREGUES	Pikat në rast të përmbushjes	Maks. pikë	
	1	Lokacioni i projektit	Përderisa investimi është i vendosur në komunat me qendra rurale, vendbanime malore dhe kodrinore, zona kufitare, zona të pazhvilluara ekonomike ose specifike (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 79/09)	15	35
			Përderisa investimi është i vendosur në komunë e cila gjendet në afërsi të zonës së mbrojtur në pajtim me Ligjin për mbrojtje të natyrës (Gazeta Zyrtare e RM nr. 67/04, 14/06, 84/07, 35/10)	10	
			Përderisa investimi është i vendosur në komunën e cila është e afërt me trashëgiminë kulturore ose gjetjet arkeologjike e cila është e emëruar në pajtim me Ligjin për mbrojtje të trashëgimisë kulturore (Gazeta Zyrtare e RM nr. 20/04, 115/07, 18/11, 148/11)	10	
	2	Krijim i mundësive për punësim	Përderisa investimi parasheh mundësi për punësim të më së paku 5 ndërsa më së shumti 10 personave	15	15
			Përderisa investimi parasheh mundësi për më së paku tre punësime të reja	10	
			Përderisa investimi parasheh mundësi për më së paku një punësimi të ri	5	
	3	Mbrojtje e traditës dhe trashëgimisë	Përderisa investimet i respektojnë cilësitë tradicionale nga hapësirat rurale atje ku janë të vendosura (pamje tradicionale e ndërtimeve të jashtme dhe të brendshme, recetat tradicionale, kuzhinë, zejтари etj.)	20	20
	4	Promovim i veprimtarive bashkëpunuese	Përderisa bëhet fjalë për projekte të përbashkëta të cilat kyçin partneritete private mes operatorëve të ndryshëm ekonomik rural	10	10





	5	Përmirësimi i strukturës gjinore dhe moshës në hapësirat rurale	Përderisa personi përgjegjës ndaj personit ligjor është grua gjegjësisht udhëheqës i ekonomisë bujqësore për të cilën dërgohet investimi është grua	10	20
			Përderisa investimi është i promovuar nga persona të moshës prej 18 deri 40 vjet	10	

